



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 8 qershor 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Sabri Hamiti, Donika Kadaj- Bujupi, Amir Ahmeti dhe Petar Miletqi.

Mungoi: Skënder Hyseni.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha – OSBE, Lumnije Murati- ZPRK, Shefki Kastrati- NDI dhe Shkelzen Lushaku- KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 25 maj 2011;
3. Miratimi i propozimit lidhur me inicimin e Institutit Kombëtar të Diasporës;
4. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Grupit të Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
5. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve;
6. Miratimi i listës së ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit,
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës, me shtyrjen e shqyrtimit të propozimit për formimin e Grupit të Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për mbledhjen e radhës.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 25 maj 2011;

Kryetari konstatoi se, Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 25 maj 2011.

3. Miratimi i propozimit lidhur me inicimin e Institutit Kombëtar të Diasporës;

Albin Kurti – Tha se në mbledhjen e kaluar është diskutuar lidhur me inicimin e një Instituti Kombëtar të Diasporës, e cila iniciativë në parim është përkrahur nga Komisioni. Mbështetur në diskutimet nga mbledhja e kaluar, është propozuar një draft-propozim lidhur me inicimin për formimin e Institutit Kombëtar të Diasporës bashkë me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Hydajet Hyseni - Lidhur me inicimin e Institutit Kombëtar të Diasporës tha se ka pasur përshtypjen se në mbledhjen e kaluar është përkrahur iniciativa për të bërë një koordinim në mes të Kosovës dhe vendeve me të cilat kemi mërgatë të përbashkët, njëkohësisht ceku dilemat të cilat ishin, se a është forma më e mirë për inicimin e kësaj çështjeje, Instituti? Mbështetur në draftin e propozuar, propozoi që në vend të fjalëve “institut kombëtar”, të propozohet “të angazhohet për një trup koordinues me vendet e tjera”, ose të gjendet një formë më e përshtatshme për këtë çështje.

Enis Kervan - Për inicimin e kësaj çështjeje tha se duhet të kemi bazë ligjore. Nëse krijohet baza ligjore atëherë duhet shikuar, si duhet vepruar duke pasur parasysh edhe Ligjin për mërgatën. Ministria mund ta nxjerrë ligjin për institutin, por nëse Komisioni inicion nxjerrjen e ligjit për institutin kombëtar, atëherë Komisioni duhet të jetë sponsorues i ligjit.

Petar Miletqi- Kërkoi të informohet se për formimi i këtij instituti, a është menduar në një institut të diasporës vetëm për shqiptarët, apo institut të diasporës i të gjithë atyre që jetojnë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi, apo është menduar diç e tretë?

Sabri Hamiti - Përkrahu përfundimin e Komisionit dhe formulimin në draft-propozim e konsideroi të saktë. Ai tha se sipas këtij propozimi që ju referohet të dy ministrive, pasi t’ju përcillet atyre, puna e Komisionit përfundon. Ministrinë e shqyrton mundësinë dhe nevojën për formimin e këtij instituti, ndërsa sa i përket bazës ligjore tha se ajo ekziston.

Donika Kadaj Bujupi – Tha se e përkrah draft-propozimin për formimin e Institutit Kombëtar të Diasporës. Me qëllim të jetësimi më të shpejtë të këtij iniciimi, propozoi hartimin e një projekti nga Komisioni për nevojën, qëllimin, mënyrën e funksionimit të këtij instituti, që do t’i shërbente si ndihmë ministrive përkatëse.

Albin Kurti - Tha se më mirë është të propozojmë të formohet një institut, se sa një trup koordinues ose i përbashkët, sepse instituti është ai i cili bënë hulumtime dhe studime socio-kulturore e arsimore afatgjate, ndërsa trupi i përbashkët merret më shumë me politika afatshkurte brenda mandatit të Qeverisë. Ky institut nuk do të ishte përjashtues ndaj të tjerëve, por para së gjithash do të ishte shqiptar duke pasur parasysh se shumica e qytetarëve që jetojnë jashtë janë shqiptarë.

Shaip Muja - Çështja e inicimit të formimit të Institutit Kombëtar të Diasporës tha se kërkon pak kohë, dhe se për këtë çështje duhet të takohemi edhe të bisedojmë edhe me ministrat e Ministrisë së Diasporës dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Duhet pasur parasysh që të mos duplikohen çështjet, se kush do të jenë njerëzit udhëheqës të institutit, cilat do të jenë objektivat e tij, dhe a do t’i përgjigjet instituti, Kuvendi apo do të jetë i pavarur? Ky institut, po ashtu, duhet të respektojë edhe karakterin multietnik të shoqërisë sonë.

Hydajet Hyseni - Propozoi që termit diasporë t'i shtohet edhe termi mërgatë, mbështetur në arsyetimin e diskutuar në mbledhjen e kaluar.

Petar Miletqi- Në diskutimin e tij në mes tjerash tha se kjo iniciativë së pari duhet diskutuar me ministrin e Ministrisë së Diasporës dhe atë të Punëve të Jashtme, që këta të korrespondojnë dhe shqyrtojnë se a është e mundur dhe a është funksionale kjo iniciativë. E përkrah iniciativën, por shpreh dyshimin në grumbullimin e institucioneve të cilat merren me të njëjtën punë.

Albin Kurti - Tha se nuk ka grumbull të instituteve në Kosovë. Ky institut nuk do të ishte institut politik, por socio-kulturor me karakter shkencor, studiues e hulumtues. E mbështeti propozimin që pas fjalës diasporës, të shtohet fjala mërgatës.

Amir Ahmeti –E përkrahu iniciimin për formimin e institutit. Shtroi çështjen se çka do të ndodhë me këtë iniciativë, nëse do ta ketë mbështetjen nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme, por nuk do të përkrahet nga vendet e tjera?

Albin Kurti - I njoftoi se Shqipëria pranë MPJ- së ka një institut të diasporës. Formimi i këtij institutit tha se ka mundësi të mos zgjerohet, ashtu siç është menduar, por me Shqipërinë besojmë se do të haset mirëkuptimi i parë.

Amir Ahmeti - Ndër të tjera ceku se do të ishte mirë që secili vend t'i formojë institutet e veta në bazë të rregullave të veta, e pastaj të bashkëpunohet me vendet e tjera, për të evituar dështimin e mundshëm të formimit të institutit në fjalë.

Hydajet Hyseni - Propozoi që formulimi i këtij propozimi të jetë institut i përbashkët për mërgatën, në vend të termit kombëtar, sepse me këtë formulim nuk do të mund të kundërshtohet nga askush propozimi ynë. Po ashtu propozoi që të ftohen ministrat përkatës për të biseduar dhe gjetur një formë të përshtatshme për këtë iniciativë.

Shaip Muja - Propozoi që të ftohet Naim Dedushaj, ministër i Ministrisë së Diasporës dhe ai i Ministrisë së Punëve të Jashtme që së bashku ta diskutojnë vetëm këtë çështje.

Pas diskutimeve të shumta nga anëtarët e Komisionit kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundimin

Propozimi për iniciativën për formimin e një Instituti Kombëtar të Diasporës bashkë me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, të nxirret në njërën nga mbledhjet e radhës së Komisionit.

4. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve;

Albin Kurti –Duke u mbështetur në nenin 73 të Rregullores së Kuvendit, tha se Komisioni është i autorizuar ta mbikëqyrë zbatimin e ligjeve brenda fushës së përgjegjësisë së tij. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është paraparë në Programin e punës, por është edhe kërkesën e Planit të Veprimit të Kuvendit për vitin 2011, që çdo komision të bëjë së paku monitorimin e një ligji në tremujorin e dytë të këtij viti. Propozoi që Komisioni të përcaktohet për monitorimin e Ligjit për

Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, si dhe të formohet grupi punues për monitorimin e tij.

Pas diskutimeve të deputetëve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundimin

Të monitorohet Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës nr. 03/L-044, së bashku me Ligjin për plotësimin e ndryshimin e tij. Formohet grupi punues për monitorimin e ligjit në fjalë në përbërje:

Albin Kurti, kryesues i grupit punues,

Hydajet Hyseni, anëtar i grupit punues dhe

Donika Kadaj- Bujupi, anëtare e grupit punues.

5. Miratimi i listës së ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit

Albin Kurti - I njoftoi se ekziston një listë e ekspertëve të fushës së Komisionit tonë, e cila kërkohet që të miratohet në Komision. Kjo për arsye se, nëse Komisioni gjatë punës së tij ka nevojë të angazhojë ndonjë ekspert, atëherë i referohet kësaj liste zyrtare të ekspertëve dhe identifikon ekspertët e nevojshëm për çështjen e caktuar. Kjo listë mund të plotësohet nga ana e Komisionit dhe pastaj të miratohet.

Lidhur me listën e ekspertëve diskutuan deputetët: S. Hamiti, Sh. Muja, E. Kervan, dhe H. Hyseni.

Pas diskutimeve të deputetëve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundimin

Lista e ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së bashku me propozimet e reja për ekspertë, nga anëtarët e Komisionit.

6. Të ndryshme

1. Kryetari i Komisionit, i njoftoi anëtarët e Komisionit me ftesën e cila i është bërë ministrit Enver Hoxhaj, për takim me Komisionin dhe se ende nuk e kishte marrë përgjigjen.
2. Komisioni vendosi që të ftohet zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, të hënën më 13 qershor, që t'i njoftojë lidhur me bisedimet me Serbinë.
3. Deputeti Shaip Muja, propozoi që me rastin e takimit të Komisionit me ministrin Enver Hoxhaj, të ftohet edhe zëvendëskryeministri Bexhet Pacolli, që t'i njoftojë lidhur me aktivitetet e tij rreth njohjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti